



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:250374

Datë: 22.04.2024

Numri i dokumentit: 05602098

**PKR.nr.299/2023**

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA**, në përbërje nga kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Naser Foniqi, me bashkëpunëtoren profesionale Arbenita Hoxha Koleci, në çështjen penale të akuzuarit I.G., i akuzuar për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale Vrasje e rëndë, nga neni 173 par. 1 pikat 1.3 dhe 1.4 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës – në vijim KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda PP.I.nr.876/2022, të datës 16.05.2023, pas shqyrtimit fillestar të datës 09.10.2023, të hapur për publikun, dhe shqyrtimit gjyqësor të mbyllur për publikun të mbajtur me datat 26.01.2024, 14.03.2024 dhe 17.04.2024, në të cilin kanë qenë të pranishëm: prokurori i shtetit Javorka Princevic, e dëmtuara A.G. me mbrojtësin e viktimave V.A., eksperti i Institutit të Psikiatrisë Forenzike të Kosovës Dr.A.G., i akuzuari I.G. me mbrojtësen e tij av. Myrvete Hashani – Jashari, e caktuar sipas detyrës zyrtare, si dhe përkthyesit e gjykatës B.K., F.D. dhe A.B., me datë 17.04.2024, mori dhe publikisht shpalli këtë:

## A K T G J Y K I M

**I akuzuari I.G.**, i biri i L. dhe H., e vajzërisë A., i lindur me datë ..., në Prishtinë, rruga “M.I.”, numër ..., me numër personal ..., ka të kryer shkollën fillore, i ve, – babë i dy fëmijëve, pensionist – realizon pension në shumë prej 182 euro, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, **gjendet nën masën e paraburgimit prej datës 25.11.2022**,

## ËSHTË FAJTOR

**S e p s e:** me datë 25.11.2022 rreth orës 04:00 në shtëpinë e tij në Prishtinë, në rrugën “M.I.” numër ..., në mënyrë mizore dhe dinake, ka privuar nga jeta anëtarin e familjes së tij – ish bashkëshorten e tij, tani të ndjerën S.G., në atë mënyrë që deri sa tani e ndjera ka qenë duke fjetur në shtratin e saj, tani i akuzuari me sëpatë si mjet i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimeve të rënda trupore dhe rrezikimin e jetës, tani të ndjerën e ka goditur disa herë në pjesën e majtë të kokës, duke i shkaktuar asaj lëndime të rrezikshme për jetën, e për shkak të të cilave tani e ndjera ka ndërruar jetë dhe vdekja i ka ardhur si rrjedhojë e shkatërrimit të masës trunore si dhe gjakderdhjes brenda trunore në cipat e buta të trurit në të dyja anët e saj, si dhe me thyerje të kockave të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë, të rëndë dhe relativisht të mprehtë,-  
- me këto veprime, i akuzuari ka kryer veprën penale Vrasje e rëndë, nga neni 173 par. 1 pikat 1.3 dhe 1.4 të KPRK.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve: 38; 42; 69; 70; 79 dhe 173 par. 1 pikat 1.3 e 1.4 të KPRK, si dhe nenit 364 të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale – në vijim KPP, të akuzuarit i shqipton:

### DËNIM ME BURGIM

- Në kohëzgjatje prej tridhjetë e pesë (35) vite, të cilin dënim, i akuzuari I.G. do ta mbaj pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.
- Në dënimin e shqiptuar, të akuzuarit do t'i llogaritet edhe koha e kaluar nën masën e paraburgimit prej datës **25.11.2022 e derisa të jetë nën këtë masë.**
- Të akuzuarit I.G., i vazhdohet masa e paraburgimi deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, por jo më shumë se dënimi i shqiptuar me këtë aktgjykim.
- Detyrohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale aq sa dalin sipas regjistrit të shpenzimeve, ndërsa në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej **pesëdhjetë (50) € dhe pesëdhjetë (50) € për Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit**, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- **Të akuzuarit i** konfiskohet Arma e ftohtë – sëpata e përdorur për kryerjen e veprës penale dhe e njëjta duhet të shkatërrohet.
- **E dëmtuara A.(I)G.**, nga Podujeva, rr. "...", pa numër, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

### ARSYETIMI

Pas kallëzimit penal të Policisë së Kosovës/Drejtoria Rajonale e Policisë / Njësia e Hetimeve të Përgjithshme në Prishtinë rasti numër 2022-AB-3247, të datës 25.11.2022, Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda, ndaj të akuzuarit I.G. ka ngritur aktakuzën PP.I.nr.876/2022, të datës 16.05.2023, për shkak të veprës penale Vrasje e rëndë, nga neni 173 par. 1 pikat 1.3 dhe 1.4 të KPRK.

Me aktgjykimin e kësaj gjykate PKR.nr.188/2023 të datës 30.05.2023, i akuzuari I.G. është shpallur fajtorë për veprën penale për të cilën është akuzuar nga prokuroria dhe atij i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëzet e pesë (25) vite.

Lidhur me këtë çështje penale, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PAKR.nr.440/2023, të datës 26.09.2023, e ka anuluar aktgjykimin e Gjykatës Themelore Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.188/2023, të datës 30.05.2023, me sugjerim që gjykata e shkallës së parë, duhet që të caktoj sërish çështjen penale, të filloj me procedim të së njëjtës, sipas dispozitave përkatëse ligjore, t'i jepet hapësirë më e madhe të akuzuarit për tu deklaruar pas leximit të aktakuzës përkitazi me pranimin apo mos pranimin e fajësisë, që të ketë kohë të mjaftueshme për konsultim me mbrojtësin, që të nxjerrën edhe provat përkatësisht ekspertiza të jetë e mbështetur në dispozitat ligjore, që janë në zbatim e sipër, që sipas procedurës dhe rrjedhës së saj, të nxjerrën dhe prova të tjera, e më pastaj të nxjerrë vendim në çështjen penale.

Në seancën e shqyrtimit fillestar të datës 09.10.2023, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i akuzuari I.G., ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe nuk ka nevojë për sqarime shtesë e pastaj është deklaruar i pafajshëm për veprën penale Vrasje e rëndë, nga neni

173 par. 1 pikat 1.3 dhe 1.4 të KPRK. Pastaj, mbrojtësja e të akuzuarit G. ka ushtruar kërkesë për kundërshtimin e provave dhe kërkesës për hedhjen e aktakuzës, kërkesa të cilat janë refuzuar me aktvendimin e kësaj gjykate PKR.nr.299/2023 të datës 08.11.2023, i cili është vërtetuar me aktvendimin e PN.nr.1529/23, të datës 29.11.2023.

Në fjalën hyrëse, prokurori i shtetit ka deklaruar se prokuroria ka siguruar prova të mjaftueshme të cilat e mbulojnë dyshimin e bazuar të prokurorisë që i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, e ndër të tjera prokuroria ka propozuar që në seancë të administrohen provat e propozuara në aktakuzë, duke shtuar se si provë mund të merret edhe fakti që i pandehuri I.G. ditën kritike me 25.11.2022 rreth orës 04:40, vet ka shkuar në Stacionin Policor Qendra në Prishtinë dhe e ka paraqitur vetveten pranë zyrtarëve policorë se e ka mbytur bashkëshorten e vet - tani të ndjerën S.G., në shtëpinë e tyre familjare e cila gjendet në rrugën "M.I." në Prishtinë, pastaj policia ka dalë në vendin e ngjarjes në shtëpinë e të pandehurit, ku e ka gjetur trupin e të ndjerës S.G. dhe ka bërë shikimin e vendit të ngjarjes për të cilën është përpiluar raporti për gjendjen e hasur në vendin e ngjarjes dhe të gjitha gjërat të cilat janë relevante për këtë rast. Pastaj, prokurori i shtetit ka thënë se i pandehuri I.G. asnjëherë nuk ka dhënë deklaratë në të cilën do të përshkruhej se çfarë ka ndodhur mirëpo nuk ka asnjë dëshmitarë dhe ai është i vetmi i cili mundet të sqaroj se çka ka ndodhur natën kritike por edhe vet fakti që ai e ka paraqitur kryerjen e veprës penale, e që policisë në mënyrë verbale ia ka sqaruar se si e ka kryer atë, po ashtu i ka cekur arsyet përse e ka kryer, e kjo është e mjaftueshme që ta bindë gjykatën që ai e ka kryer këtë, duke theksuar se prokuroria në procedurën hetimore ka parashtruar kërkesë që të bëhet ekspertiza e gjendjes psikike të tani të akuzuarit në momentin e kryerjes së veprës penale dhe në momentin e ekspertimit, e për këtë grupi i psikiatërve në përbërje prej Dr. A.G., Dr. J.Z.dhe A.V.- psikologe klinike, kanë vërtetuar se te i akuzuari I.G. është përjashtuar çrregullimi i kualitet psikotik, akut dhe kronik, prapambetja mendore apo çrregullimi mendor si pasojë e dëmtimeve cerebrovaskulare trunore, nuk janë gjetur elemente të natyrës psikiatrike dhe psikologjike që kanë mundur të ndikojnë në aftësinë për të kuptuar dhe kontrolluar veprimet e veta dhe se i njëjti mund të merr pjesë ne procesin gjyqësor si dhe deklaratat e tij janë valide, e ky është njëri nga faktet që i akuzuari mund të marr pjesë në procedurën gjyqësore, është i vetëdijshëm se për çka udhëhiqet procedura dhe mund të deklarohet në lidhje me këtë procedurë.

Ndërsa, në fjalën përfundimtare, prokurori i shtetit ka deklaruar se pas procedurës së administrimit te provave me analizimin dhe vlerësimin e provave të administruara dhe të pranuara, në mënyrë të padyshimtë është vërtetuar dyshimi i bazuar i prokurorisë, i sqaruar gjatë ngritjes së aktakuzës, se tani i akuzuari ka kryer veprën penale Vrasje e rëndë, nga neni 173 par. 1 pikat 1.3 dhe 1.4 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës për të cilën akuzohet me aktakuzën PP.I.nr. 876/2022 të datës 12.05.2022 në mënyrë të padyshimtë është vërtetuar se i akuzuari I.G. me datë 25.11.2022 rreth orës 04:40 ka shkuar në Stacionin Policor në Prishtinë dhe e ka paraqitur, më saktë ka deklaruar se ka ardhur të dorëzohet sepse e ka vrarë bashkëshorten e vet - tani të ndjerën S.G., pastaj me policët të cilëve iu ka sqaruar se ku ka ndodhur vepra, kanë shkuar në vendin e ngjarjes në shtëpinë e të akuzuarit dhe të ndjerës, e ku është gjetur trupi, gjithashtu në bisedë me policinë i akuzuari e ka sqaruar edhe motivin duke theksuar se është ndier i anashkualuar dhe ka qenë xheloz, ndërsa nga provat materiale të cilat janë të propozuara konkretisht Raporti i forenzikës nga vendi i ngjarjes i datës 25.11.2022 shihet edhe arma gjegjësisht sëpata të cilën e ka shfrytëzuar i akuzuari gjatë kryerjes së veprës penale të cilën e ka kryer deri sa viktima ka qenë duke fjetur në shtratin e saj dhe që nuk ka mundur të mbrohet, ndërsa nga lëndimet e shkaktuara nga i akuzuari, ajo ka vdekur në vendin e ngjarjes.

Mbrojtësi i viktimave, në fjalën hyrëse ka thënë se e mbështet fjalën hyrëse të prokurorit të shtetit. Ndërsa, në fjalën përfundimtare mbrojtësi i viktimave ka thënë se e mbështet fjalën

përfundimtare të prokurores së shtetit dhe ka kërkuar nga trupi gjykues që pas administrimit të provave materiale të pandehurin ta shpallë fajtor sipas dispozitave të KPRK.

E dëmtuara A.G. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se kërkon kompozim dëmi por tani për tani vlerën nuk e di, duke shtuar se nuk është eksperte e fushës por ka menduar dhe dyshon se prindi i saj nuk ka qenë në gjendje normale kur e ka kryer veprën penale sepse me qenë normal dhe me mbytë një njeri asaj i duket absurde.

Mbrojtësja e të akuzuarit, në fjalën hyrëse ka deklaruar se kjo gjykatë në procedurën e rishqyrtimit nuk i është përmbajtur udhëzimeve të dhëna nga gjykata e shkallës së dytë me saktësisht me të cilin është udhëzuar që së pari t'i eliminoj shkeljet e dispozitave gjyqësore si marrja në pyetje në procedurë paraprake dhe më konkretisht është shkelur neni 134 dhe 135 sa i përket ekspertizës psikiatrike me të cilën ekspertizë janë tejkualuar të gjitha afatet si gjyqësore ashtu edhe ligjore, bazuar në urdhëresën e gjykatës me numër PPRKR.646/22 të datës 29.11.2022 me të cilën gjyqtari i procedurës paraprake ka urdhëruar që i pandehuri të ekzaminohet nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike dhe të vërtetohet se në kohën e kryerjes së veprës penale a ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore apo aftësisë së zvogëluar mendore.

Ndërsa, në fjalën përfundimtare mbrojtësja e të akuzuarit ka deklaruar se ashtu siç ka deklaruar edhe në fjalën hyrëse nga provat të cilat janë administruar në këtë proces gjyqësorë e në veçanti nga raporti i Institutit të Psikiatrisë Forenzike të Kosovës – në vijim IPFK i datës 15.02.2023 mbi gjendjen e shëndetit mendor për të akuzuarin, mbi bazën e të cilit nuk është arritur të vërtetohet saktë nëse i akuzuari në kohën për të cilën akuzohet se e ka kryer veprën penale ka qenë në gjendje ta kuptoj rëndësinë e veprimeve të tij pasi që edhe nga raporti raportohet për një gjendje të vazhdueshme të vetëbesimit të ulët, ndjenjën e inferioritetit e të qenit i neglizhuar, i pa dobishëm, jo i dashur, i pa respektuar, për faktin se i njëjti nuk është marrë parasysh nga familjarët, konkretisht nga ish bashkëshortja, e më vonë edhe nga fëmijët dhe se mendimet apo propozimet e tij nuk janë përfillur, janë neglizhuar dhe se në marrjen e vendimeve familjare ka qenë totalisht i pa përfshirë, duke ndikuar që i njëjti të ndihet si i tillë dhe krejt kjo ka ndodhur në vazhdimësi është e pamundur të mos ndikoj në gjendjen shëndetësore, marrë parasysh edhe moshën e tij, e krejt kjo duke u nisur edhe nga të drejtat dhe obligimet bashkëshortore që bashkëshortët kanë në martesë, që të jenë të barabartë në mënyrë reciproke, ta ndihmojnë, respektojnë dhe mbështesin njëri tjetrin në të gjitha vendimet familjare. Pastaj, mbrojtësja ka thënë se konsideron se ky raport është përfshirë më shkelje të dispozitave ligjore në fuqi, nuk ka qenë objektiv dhe i njëjti është përfshirë në shkelje të afateve ligjore si për nga ekspertimi ashtu edhe për nga komunikimi dhe me gabime të shumta teknike dhe i mangët, e që bie ndesh me deklarinimin e ekspertit Dr. A.G. i cili në seancën e datës 14.03.2024 ka deklaruar “përkundër presionit të kohës, e rëndësishme ka qenë që ekspertiza të përfundoj në mënyrë profesionale”, gjë që me gjithë këto lëshime nuk të jep përshtypjen e një ekspertize profesionale, por jo profesionale po ashtu e bën deklarinimi i ekspertit në pyetjen e të dëmtuarës A.G., kur thotë “ fillimisht rezultatet e CT kanë qenë me disa ndryshime, e për të cilat në fillim ka menduar se mund të kenë pasur ndikim në gjendjen psikike dhe e dyta se në atë kohë eksperti në fjalë e ka luajtur rolin e doktorit dhe jo të ekspertit” është shumë jo profesionale dhe jo etike pasi që vet fjala ekspertizë nënkupton besimin për vlerësim profesional dhe jo mbështetjen emocionale të familjarëve, e në fund deklarinimi i ekspertit se ndjenja e inferioritetit të vazhdueshëm, mos përfshirja apo ndjenja që ka qenë i pa përfshirë në vendime familjare duke u ndier i lënë anash nuk ka ndikim të madh në pjesën e përgjegjësisë, e po ashtu të jep përshtypjen e jo profesionalizmit sepse është shumë e pamundur që rrethanat në të cilat jetojmë çdo ditë të mos ndikojnë në shëndetin tonë mendor ashtu siç ndikon çdo rrethanë dhe faktor tjetër në mënyra të ndryshme të ne. Po ashtu, mbrojtësja e të akuzuarit ka theksuar se nga deklarata e të dëmtuarës A.G. në seancën e datës 14.03.2024 por edhe nga deklarinimet e bëra në prokurori, bazuar në

procesverbalin e datës 13.12.2022 e njëjta ka deklaruar se në kohën e fundit kanë vërejtur se babai ka pasur ndryshime të humorit, herë pas here ka qarë dhe ka thënë se nuk po e do askush, e herë pas here i njëjti ishte i qetë dhe se vet e dëmtuara në këtë rast por edhe nëna e saj kanë pasur dyshime në aftësinë psikike të të pandehurit dhe se të pandehurit disa herë me radhë i kanë propozuar që të vizitoj një psikiatër, dhe e gjithë kjo është bazë e mjaftueshme për të dyshuar në përgjegjësinë penale të të pandehurit në raport me veprën penale, pasi i pandehuri nuk ka pranuar të shkoj te psikiatri sepse nuk ka dyshim që një person i cili është apo vuan nga sëmundjet mendore të pranoj se nuk është në gjendje të mire psikike, nisur nga gjithë kjo me të vërtetë është e pamundur të anashkalohet gjendja e tij psikike dhe përgjegjësia penale në raport me veprën për të cilën akuzohet, andaj nga gjykata ka kërkuar që me rastin e marrjes së vendimit t'i peshoj të gjitha këto fakte, me qëllim që ndaj të pandehurit të merret një vendim i ligjshëm dhe në rast se të pandehurin e gjen përgjegjës në raport me veprën, të marrë parasysh fillimisht faktin se i njëjti nuk ka rënë ndesh me ligjin asnjëherë deri tani, ka qenë bashkëpunues dhe nuk iu ka shmangur bashkëpunimit, ndërsa me rastin e marrjes dhe matjes së dënimit, të pandehurit t'i shqiptoj dënim nën minimumin e paraparë ligjor, pasi që marrë parasysh moshën e tij jashtëzakonisht të shtyrë, çdo dënim që do t'i shqiptohet mbi 10 vite, për të do të konsiderohet dënim me burgim të përjetshëm.

Në fjalën e tij përfundimtare, i akuzuari I.G. ka thënë se e përkrah fjalën përfundimtare të mbrojtëses së tij dhe ka shtuar se i vjen keq për atë që ka ndodhur dhe i ka rënë pishman, përkatësisht është penduar.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të kaluar dhe në këtë shqyrtim gjyqësor, janë dëgjuar e dëmtuara, eksperti IPFK dhe janë administruar provat materiale të propozuara nga prokuroria në aktakuzë dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, e të paraqitura si në vijim:

Nga dëshmia e të dëmtuarës - dëshmitares A.G., e cila nën betim ka deklaruar se si çdo çift edhe prindërit e saj kanë pasur momente të mira por kanë pasur edhe mosmarrëveshje të natyrave të ndryshme, përkatësisht janë shtyrë me fjalë por dhunë fizike nuk kanë pasur asnjëherë, aq sa di ajo, ndërsa kohëve të fundit prindi i saj ka xhelozuar në nënën e saj, pasi kishte dyshime se ajo po del me dikë, e për këtë e përcillte nënën te shkolla për ta parë me kë po del. Po ashtu, e dëmtuara - dëshmitarja A.G. ka thënë se nëna e saj e ka përmendur në kohën e fundit se ka dashur të shkoj me koleget e punës në Shqipëri për 28 nëntor, por se prindi i saj gjithnjë ka qenë xheloz, nuk e ka lënë të lirë të dal, të shkoj nëpër ndeja të punës, përkatësisht për këtë e di se kanë pasur telashe, edhe për atë se nëna e saj – tani e ndjera e ka përmendur se ka dashur t'i thotë vëllait të saj, I., që ta pyes babanë për ta lejuar të shkoj në Shqipëri me koleget pasi ajo nuk mund të merrej vesh me të, por se çka ka ndodhur më tutje dhe nëse nëna ka biseduar me vëllain ajo nuk e di, pasi nuk ka dashur ta diskutoj këtë kohën e fundit sepse i shkaktonte probleme emocionale, duke shtuar se lidhur me shkuarjen e nënës së saj në Shqipëri, ajo dhe vëllai e kanë përkrahur atë – tani të ndjerën pasi nuk ka pasur diçka të keqe, dhe se përveç mosmarrëveshjeve rreth udhëtimit të tani të ndjerës në Shqipëri me koleget e saj, babai kohëve të fundit e ka ofenduar tani të ndjerën por ata kanë menduar se këtë po e bën për shkak të moshës, e kanë lëshuar nervat dhe një ditë para se të ndodhte ngjarja babai i saj – tani i akuzuari nuk e ka lënë nënën e saj – tani të ndjerën të flejë tërë natën duke folur mbarë e mbrapsht, e këtë ia kishte thënë nëna e saj përmes telefonit të nesërmen dhe mezi i kishte mbajtur orët e mësimi pasi ishte pa gjumë, e pastaj natën e së nesërmen ka ndodhur ngjarja. Pastaj, e dëmtuara - dëshmitarja A.G. ka theksuar se kur ka biseduar më nënën e saj telefon, asaj i ka thënë “dil flejë në dhomën tjetër”, e ajo i kishte thënë “po flejë edhe sonte e mandej të shoh” por ngjarja kishte ndodhur këtë natë.

Në pyetje nga mbrojtësi i të akuzuarit, e dëmtuara - dëshmitarja A.G. është përgjigjur se kohën e fundit babai i saj ka pasur ndryshime, herë pas here ka qarë, ka thënë se nuk po e do kurrkush, mandej ishte i qetë, ndërsa ata nuk e dinin çka po ndodhte me të, pastaj ajo – tani e dëmtuara ka tentuar disa herë që babanë ta dërgoj te psikiatri por ai nuk ka pranuar duke i thënë “ju jeni për psikiatër sepse unë jam mirë”, duke shtuar se për gjendjen e babait të saj nuk kanë diskutuar me të tjerët sepse ka qenë diçka private, përveç me dajat e saj, të cilët kanë qenë të njoftuar dhe ata kanë thënë që zgjidhja e vetme që babai dhe mami të ndahen të jetojnë veçmas, por duke menduar se ai po qetësohet, po bëhet mirë, nuk kanë ndërmarrë asgjë edhe pse mami e ka diskutuar me dajën që ajo të dal dhe të jetoj vet duke thënë se ajo nuk po bënte asgjë të keqe dhe nuk kishte pse të dilte nga shtëpia.

Po ashtu, e dëmtuara - dëshmitarja A.G. ka thënë se prindërit e saj shtyheshin me fjalë, derisa babai i ka thënë të dal nga shtëpia pastaj qetësohej, por edhe mami –tani e ndjera kur kanë pasur mosmarrëveshje ka tentuar të dal nga shtëpia por prapë nuk ka dalë, duke marrë parasysh edhe moshën e tyre, duke theksuar se tani e ndjera – nëna e saj ka pasur dyshime në aftësinë psikike të babait të saj por nuk kanë kërkuar ndihmën e ndonjë eksperti adekuat për të ardhur në shtëpi për ta vizituar babain e saj pasi këtë nuk e kanë marrë shumë serioze duke pasur parasysh moshën e tij.

I akuzuari I.G. ka thënë se nuk ka pyetje për të dëmtuarën - dëshmitaren A.G. e as nuk ka vërejtje në thëniet e saj.

Në pyetje nga KTGJ, e dëmtuara - dëshmitarja A.G. është përgjigjur se prindërit e saj kanë jetuar vet që nga viti 2019, pasi ajo në atë kohë është martuar dhe ka dalë nga shtëpia, ndërsa vëllai i saj nga viti 2011 jeton në Zvicër, duke shtuar se natën kur ka ndodhur ngjarja nuk ka njohuri nëse babi dhe mami kanë pasur ndonjë mysafir, dhe se atë natë përmes viber e ka thirrur babain e saj me kamerë, ka biseduar me të derisa tani e ndjera – nëna e saj ka qenë më tutje dhe herë pas here ka folur edhe ajo, por nuk ka vërejtur diçka, përkatësisht babai kishte qenë i qetë dhe gjatë asaj kohë ka folur edhe me djalin e saj në viber. Po ashtu, e dëmtuara - dëshmitarja A.G. ka thënë se të nesërmen e kanë thirrur policia rreth orës 07:00 në mëngjes dhe kanë kërkuar nga ajo që të shkoj në stacionin policor, pa e njoftuar se çka kishte ndodhur, pastaj ia kanë kërkuar numrin e burrit të saj, të cilin e kanë njoftuar për ngjarjen, por ajo për ngjarjen ka kuptuar nga policia, ndërsa vëllain e saj e ka lajmëruar burri i saj, e pastaj vëllai i saj ka ardhur nga Zvicra, duke shtuar se gjatë qëndrimit në Kosovë vëllai i saj ka ndenjur me prindërit dhe është munduar gjithherë ta qetësoj situatën mes tyre, përkatësisht ka biseduar me babin, i cili i ka thënë se kjo nuk do të ndodh më, por prapë ka vazhduar, duke u shtyrë për hiq gjë, por ata - fëmijët gjithmonë ia kanë lënë fajin moshës. Pastaj, e dëmtuara - dëshmitarja A. ka thënë se ka pasur raste kur babi i saj – tani i akuzuari I. i ka kërcënuar se do t’i mbys edhe nënën edhe ata – djalin dhe vajzën, por kanë menduar se thëniet e tij janë momentale dhe nuk kanë besuar se do të bënte diçka siç ka bërë me nënën e saj, duke shtuar se babi i saj në të kaluarën ka pasur forcë, ka kryer punët e shtëpisë, ka prerë dru me sëpatë, por kohën e fundit mendoj se forca e tij ka qenë më e dobët, duke theksuar se veprën penale e ka kryer babi i saj – tani i akuzuari sepse nuk ka pasur kush ta kryej, dhe se nuk ka njohuri nëse dikush tjetër jashtë familjes së tyre ka pas ndonjë motiv për ta mbytur nënën e saj – tani të ndjerën S.

Në pyetje nga ATGJ Fatime Dërmaku, e dëmtuara - dëshmitarja A.G. është përgjigjur se nëna e saj është kujdesur për babin, për ushqimin e tyre, e ka trajtuar atë – tani të akuzuarin si fëmijë, pasi i njëjti nuk ka pasur patentë shofer dhe nuk ka punuar, ndërsa nëna e saj tani e ndjerë e ka sjellë rrogën në shtëpi, e në krahasim siç tani i akuzuari është sjellë me të, ajo – tani e ndjera e ka marrë gjithmonë me të mirë, duke shtuar se asnjëherë nuk ka vërejtur se nëna e saj po shkonte me dikë tjetër, por mendon se tani të akuzuarit i ka hyrë një mendje e keqe në kokë dhe e ka bërë këtë, pasi ajo tani e dëmtuara A. i kishte thënë tani të akuzuarit “a ke fakte, gjej ndonjë fotografi” por ai nuk kishte ndonjë fakt se mami po e tradhton, e as ajo nuk ka pasur asnjë dyshim për nënën, duke theksuar se njeriu vërehet kur bën gjëra të këqija, dhe se tani e ndjera telefonin

e ka lënë në dhomën ku ka fjetur tani i akuzuari dhe ka qenë transparente me të, ndërsa në pleqëri tani e ndjera dhe tani i akuzuari kanë fjetur në një dhomë por në shtrate të ndara.

Dëshmia e ekspertit të IPFK, Dr. A.G., e dhënë nën betim, në të cilën ka theksuar se në faqen 8 të ekspertizës është konkludimi i grupit të ekspertëve, përpilues të ekspertizës në të cilin kanë konstatuar se të ekzaminuari I.G. është përjashtuar çrregullimi i kualitetit psikotik, akut dhe kronik, prapambetja mendore, apo çrregullimi mendor si pasojë e dëmtimeve cerebrovaskulare trunore, përkatësisht, nuk janë gjetur elemente të natyrës psikiatrike dhe psikologjike që kanë mundur të ndikojnë në aftësinë për të kuptuar dhe kontrolluar veprimet e veta, i njëjti mund të marrë pjesë në proces gjyqësor si dhe deponimet e tij janë valide, duke shtuar se për ekspertizë është dhënë afati 2+2 javë, gjë të cilën e kanë ditur dhe e dinë, e po ashtu ka njohuri se tani i akuzuari ka qëndruar më gjatë se katër javë për shkak të ndjesisë së rastit, peshës së rastit, ekzaminimeve laboratorike, imazherike (rezonancat, mri, CT), radiologjike, numri i madh i rasteve për ekzaminim dhe në fund më e rëndësishmja ka qenë se kanë dashur që ekspertiza të përfundoj në mënyrë profesionale pavarësisht presionit të kohës, gjë për të cilën kanë kontaktuar me gjyqtarin e çështjes në procedurë paraprake dhe zakonisht për zgjatjen e afatit, me gjyqtarët komunikojnë përmes telefonit. Pastaj, eksperti G. ka thënë se ata si ekip i ekspertëve punojnë në mënyrë profesionale, pa paragjykuar apo menduar nëse i ekzaminuari mund të ketë aftësi të kufizuara, mund të jetë me përgjegjësi të ruajtur apo jo dhe për t'i eliminuar të gjitha këto vijë në një konstatim të përbashkët të cilin e dorëzojnë në formë të raportit të shkruar me të gjeturat e ekipit vlerësues, duke konsideruar se konkludimi i ekipit vlerësues i dhënë në ekspertizë i përgjigjet moshës së të ekzaminuarit në raport me moshën në të cilën është kryer dhe momentin e kryerjes së veprës penale.

Në pyetje nga prokurori i shtetit, eksperti A.G. ka thënë se të dhënat familjare dhe personale për të ekzaminuarin I.G. fillimisht janë siguruar nga vetë i ekzaminuari gjatë intervistimit, por janë konfirmuar edhe nga vajza e tij A.G., duke shtuar se si ekip ekspertësh nuk kanë gjetur mospërputhje në mes të dhënave të siguruara nga i ekzaminuari I.G., të cilat janë përputhur me të dhënat e shkresave të lëndës në polici dhe prokurori dhe të dhënat e siguruara nga vajza e tij, e të cilat kanë qenë të ngjashme me të dhënat si më lart, e të cilat iu kanë shërbyer për të kuptuar se nuk kanë të bëjnë me person që ka ngecje në zhvillim, përkatësisht i njëjti ka qenë i vetëdijshëm për çdo gjë që ka ndodhur para rastit, gjatë rastit dhe pas rastit dhe kjo është rezultat i asaj që kanë konstatuar në pasuesin e dytë të faqes 8 të raportit, duke theksuar se ekzaminimit, tani të akuzuarin e kanë pyetur për kryerjen e veprës penale dhe gjatë kësaj bisede i ekzaminuari ka qenë i vetëdijshëm.

Në pyetje nga e dëmtuara A.G., eksperti A.G. është përgjigjur se gjatë ekzaminimit të tani të akuzuarit, ai ka komunikuar me të – të dëmtuarën A. dhe është e vërtetë se rezultatet e CT kanë rezultuar me disa ndryshime, për të cilat në fillim kanë menduar se mund të kenë pasur ndikim në gjendjen psikike të të ekzaminuarit dhe e dyta, konsideron se në atë periudhë e kanë luajtur rolin e doktorit e jo të ekspertit dhe duke e parë gjendjen emocionale të kuptueshme të familjarit, ata - ekspertët janë munduar që në atë periudhë t'ua bëjnë më të lehtë situatën dhe arsyen pse ka ndodhur rasti, pasi ka qenë i rëndë, përndryshe nuk ka qenë shkaktar ndonjë ndryshim i cili ka pasur ndikim në gjendjen psikike të tani të akuzuarit, duke theksuar se në ekspertizë i kanë arsyet pse ka ndodhur rasti, përkatësisht, i ekzaminuari është deklaruar se si ka ardhur deri në atë pikë - gjendje, pastaj kanë bërë vlerësimin e tij psikologjik dhe psikiatrik dhe ato të gjetura janë të përshkruara në ekspertizë dhe realisht, për ata si ekspertë, do të ishte shumë më e lehtë edhe në aspektin emocional sikur të mund të gjenin ndonjë faktorë që do të ndikonte në gjendjen psikike të I.G., pasi si profesionist, ata janë të vetëdijshëm se kjo do të ishte edhe më e lehtë dhe e pranueshme edhe për familjarët e të ekzaminuarit, por ata - ekspertët është dashur ta kryejnë vlerësimin profesional, të shkëputur nga pjesa emocionale.

Në pyetje nga mbrojtësi i të akuzuarit, eksperti A.G. ka thënë se pyetja e gjykatës në urdhrin për ekzaminim ka qenë lidhur me aftësinë mendore të personit në momentin e kryerjes së veprës penale dhe natyrisht se për të ardhur në përgjigje ata është dashur ta intervistojmë të ekzaminuarin që nga lindja e tij, shkollimi, martesja, punësimi dhe momentin e kryerjes së veprës penale - dinamikën e saj.

Në pyetje nga KTGJ, eksperti A.G. është përgjigjur se të ekzaminuarin nuk e ka parë që nga koha kur është liruar nga instituti e deri në seancën e kaluar, por i kujtohet fillimisht kur ka shkuar në institut, tani i akuzuari ka qenë në një gjendje pothuajse të ngjashme sikur në seancë, më i heshtur, më i tërhequr, më i izoluar në aktivitete dhe diskutime me persona të tjerë, por me kalimin e ditëve i njëjti është adaptuar me ambientin, është siguruar se është i mirëpritur aty, bisedat e tyre të vazhdueshme me të ekzaminuarin kanë ndikuar që të jetë me aktiv dhe më social se tani, si dhe i kujtohet se tani i akuzuari gjatë ekzaminimit ka qenë i vetëdijshëm, e ka ditur shumë mirë për veprën, për mënyrën e kryerjes së veprës, veprimet pas kryerjes së veprës dhe në atë periudhë nuk ka shfaqur keqardhje, derisa gjatë intervistimit në IPFK, tani i akuzuari është deklaruar në detaje për mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe e ka përshkruar se si e ka kryer veprën penale.

Në pyetje nga ATGJ Fatime Dërmaku, eksperti A.G. ka thënë se në vlerësimin psikologjik të përshkruar në ekspertizë është konstatuar pjesa e personalitetit të tani të akuzuarit, e ku pjesë e saj është edhe ndjenja e inferioritetit të vazhdueshëm që është ndjerë në raport me bashkëshorten për shkak të nivelit të shkollimit, punësimit, pavarësisë dhe në mënyrë të hapur ka shprehur qëndrime të pa përshtatshme në raport me pozitën apo autoritetin burrë - grua në familje, duke shtuar se pikërisht ndjenja e inferioritetit, fuqizimi i tani të ndjerës, mos përfshirja apo ndjenja që ka qenë i pa përfshirë në vendimet familjare që janë marrë duke fuqizuar sidomos rolin e gruas apo ndikimin e saj në familje, tani i akuzuari është ndjerë i lënë anash dhe presioni i herëpashershëm edhe i familjarëve në kuptimin pozitiv që kjo sjellje nuk është në rregull, përkatësisht duhet të ndryshohet, qoftë edhe diskutimi rreth trajtimit psikiatrik, ka qenë një faktor kryesor që i njëjti – tani i ekzaminuari të merr vendime për mënyrën e zgjidhjes së këtyre problemeve. Po ashtu, eksperti A.G. ka theksuar se pjesë e ekspertizës dhe diskutimeve brenda ekspertëve në këto raste është edhe shqyrtimi i ndikimit të aspektit kulturor, por kjo ka të bëjë vetëm me sqarimin se pse ka ardhur deri të kjo, pse ka ndodhur kjo vepër, por nuk ka ndikim të madh në pjesën e përgjegjësisë dhe nuk është sëmundje psikike sepse në rritimi e zhvillohemi në forma e mentalitete të ndryshme, ndërsa sjelljet e tani të akuzuarit, të përshkruara si më lart, janë pjesë e personalitetit të tij – tipareve të tij, duke shtuar se kohëzgjatja e ekzaminimit ka qenë në interes të një vlerësimi të saktë dhe profesional, pasi pas CT kanë pasur disa dyshime, pastaj kanë kryer një Angio CT për të cilën kanë pritur terminin, rezultatin dhe me këtë kanë hequr dyshimet që kanë pasur.

- Raporti i forenzikës nga vendi i ngjarjes me fotografi nga vendi i ngjarjes, në të cilin shihet tani e ndjera S.G. e shtrirë në shtrat në pozitë duke fjetur dhe e goditur në kokë në anën e majtë, e aty pranë saj mbështetur për shtrati shihet edhe sëpata – mjeti i kryerjes së veprës penale;
- Raporti i ekspertizës për gjendjen psikiatrike të akuzuarit I.G., i kryer në IPFK me datë 15.02.2023 nga ekspertët Dr. A.G.; Dr. J.Z.dhe A.V., psikologe klinike, sipas të cilit te i ekzaminuari I.G. është përjashtuar çrregullimi i kualitetit psikotik akut dhe kronik, prapambetja mendore apo çrregullimi mendor si pasojë e dëmtimeve cerebrovaskulare trunore, e po ashtu nuk janë gjetur elemente të natyrës psikiatrike dhe psikologjike që kanë mundur të ndikojnë në aftësinë për të kuptuar dhe kontrolluar veprimet e veta, si dhe i njëjti mund të merr pjesë në procesin gjyqësor, ndërsa deponimet e tij janë valide; dhe



- Raporti i autopsisë për tani të ndjerën S.G., i kryer në Institutin e Mjekësisë Ligjore - IML me datë 04.04.2023 nga eksperti mjeko ligjor Dr. D.H., sipas të cilit, shkaku i vdekjes së tani të ndjerës është si rrjedhojë e shkatërrimit të masës trunore si dhe gjakderdhjes brenda trunore dhe nën cipat e buta të trurit në të dyja anët e saj, e shoqëruar me thyerje të kockave, si pasojë e plagëve të shaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë dhe të rëndë, me buzë relativisht të mprehta, nga të cilat prova rezulton se i akuzuari e ka kryer veprën penal për të cilën akuzohet.

Pas njoftimit se ka të drejtë të mos përgjigjet, i akuzuari I.G. ka thënë se do ta shfrytëzoi të drejtën për të mos u përgjigjur përkatësisht për të mos u deklaruar për çështjen.

Pas deklarimit të akuzuarit se do ta shfrytëzoi të drejtën për të mos u përgjigjur, KTGJ ka pyetur palët në procedurë nëse kanë ndonjë propozim për plotësimin e procedurës së provave, por palët kanë deklaruar se nuk kanë propozim për plotësimin e procedurës së provave.

Po ashtu, KTGJ ka pyetur palët në procedurë nëse kanë ndonjë deklarata shtesë para përfundimit të shqyrtimit gjyqësor dhe nëse kërkojnë mbajtjen e një seance tjetër me qëllim të çështjeve të rëndësishme për caktimin e dënimit, por palët kanë deklaruar se nuk kanë ndonjë deklarata shtesë dhe nuk kërkojnë caktimin e një seance për këtë çështje.

Aktgjykimi si më lart është bazuar vetëm në faktet dhe provat e proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor, siç parasheh dispozita e nenit 360 të KPP, e për të cilat do të jepet vlerësimi si në vijim:

Nga dëshmia e të dëmtuarës - dëshmitares A.G., është vërtetuar se prindërit e saj kanë pasur momente të mira por kanë pasur edhe mosmarrëveshje të natyrave të ndryshme, përkatësisht janë shtyrë me fjalë por dhunë fizike nuk kanë pasur asnjëherë, aq sa di ajo, ndërsa kohëve të fundit prindi i saj ka xhelozuar në nënën e saj, pasi kishte dyshime se ajo po del me dikë, e për këtë e përcillte nënën të shkolla për ta parë me kë po del, e po ashtu ka pasur problem kohën e fundit kur tani e ndjera S.G. ka dashur të shkoj me koleget e punës në Shqipëri për festën e 28 nëntorit, por tani i akuzuari gjithnjë ka qenë xheloz, nuk e ka lënë të lirë të dal, të shkoj nëpër ndeja të punës, përkatësisht për këtë kanë pasur telashe, derisa kohëve të fundit, tani i akuzuari e ka ofenduar tani të ndjerën por ajo dhe vëllai i saj kanë menduar se këtë po e bën për shkak të moshës, e kanë lëshuar nervat dhe një ditë para se të ndodhte ngjarja, tani i akuzuari nuk e ka lënë nënën e saj – tani të ndjerën të flejë tërë natën duke folur mbarë e mbrapsht, e këtë ia kishte thënë nëna e saj përmes telefonit të nesërmen dhe mezi i kishte mbajtur orët e mësimi pasi ishte pa gjumë, e pastaj natën e së nesërmen ka ndodhur ngjarja. Po ashtu, nga e dëmtuara - dëshmitarja A.G., është vërtetuar se natën kur ka ndodhur ngjarja përmes viber e ka thirrur babain e saj me kamerë, ka biseduar me të derisa tani e ndjera – nëna e saj ka qenë më tutje dhe herë pas here ka folur edhe ajo, por nuk ka vërejtur diçka, përkatësisht babai i saj – tani i akuzuari kishte qenë i qetë dhe gjatë asaj kohë ka folur edhe me djalin e saj në viber, ndërsa të nesërmen e kanë thirrur policia rreth orës 07:00 në mëngjes dhe kanë kërkuar nga ajo që të shkoj në stacionin policor, e gjithashtu nga e njëjta është vërtetuar se tani i akuzuari I. i ka kërcënuar se do t'i mbys edhe nënën edhe ata – djalin dhe vajzën, por kanë menduar se thëniet e tij janë momentale dhe nuk kanë besuar se do të bënte diçka siç ka bërë me nënën e saj.

Nga dëshmia e ekspertit të IPFK Dr. A.G., është vërtetuar se te i ekzaminuari I.G. është përjashtuar çrregullimi i kualitetit psikotik, akut dhe kronik, prapambetja mendore, apo çrregullimi mendor si pasojë e dëmtimeve cerebrovaskulare trunore, përkatësisht, nuk janë gjetur

elemente të natyrës psikiatrike dhe psikologjike që kanë mundur të ndikojnë në aftësinë për të kuptuar dhe kontrolluar veprimet e veta, i njëjti mund të marrë pjesë në proces gjyqësor si dhe deponimet e tij janë valide, dhe se deri te ky mendim kanë ardhur si rezultat i ekzaminimeve laboratorike, imazherike ( rezonancat, mri, CT) dhe radiologjike. Po ashtu, nga eksperti G. është vërtetuar se tani i akuzuari gjatë ekzaminimit ka qenë i vetëdijshëm, e ka ditur shumë mirë për veprën, për mënyrën e kryerjes së veprës, veprimet pas kryerjes së veprës dhe në atë periudhë nuk ka shfaqur keqardhje, derisa gjatë intervistimit në IPFK, tani i akuzuari është deklaruar në detaje për mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe e ka përshkruar se si e ka kryer veprën penale, dhe se te i akuzuari është konstatuar pjesa e personalitetit, pjesë e të cilit është edhe ndjenja e inferioritetit të vazhdueshëm në raport me bashkëshorten – tani të ndjerën për shkak të nivelit të shkollimit, punësimit, pavarësisë dhe në mënyrë të hapur ka shprehur qëndrime të pa përshtatshme në raport me pozitën apo autoritetin burrë - grua në familje.

Nga raporti i forenzikës nga vendi i ngjarjes me fotografi nga vendi i ngjarjes, është vërtetuar se tani e ndjera S.G. është goditur në kokë në anën e majtë me sëpatë, derisa ajo ishte duke fjetur në shtrat, e aty pranë saj mbështetur për shtrati shihet edhe sëpata – mjeti i kryerjes së veprës penale;

Nga raporti i ekspertizës për gjendjen psikiatrike të akuzuarit I.G., i kryer në IPFK me datë 15.02.2023 nga ekspertët Dr. A.G.; Dr. J.Z.dhe A.V., psikologe klinike, është vërtetuar se te i ekzaminuari I.G. është përjashtuar çrregullimi i kualitetit psikotik akut dhe kronik, prapambetja mendore apo çrregullimi mendor si pasojë e dëmtimeve cerebrovaskulare trunore, e po ashtu nuk janë gjetur elemente të natyrës psikiatrike dhe psikologjike që kanë mundur të ndikojnë në aftësinë për të kuptuar dhe kontrolluar veprimet e veta, dhe se i njëjti mund të marrë pjesë në procesin gjyqësor, ndërsa deponimet e tij janë valide; dhe

Nga raporti i autopsisë për tani të ndjerën S.G., i kryer në Institutin e Mjekësisë Ligjore - IML me datë 04.04.2023 nga eksperti mjeko ligjor Dr. D.H., është vërtetuar se shkaku i vdekjes së tani të ndjerës S.G., është si rrjedhojë e shkatërrimit të masës trunore, gjakderdhjes brenda trunore dhe nën cipat e buta të trurit në të dyja anët e saj, e shoqëruar me thyerje të kockave, si pasojë e plagëve të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë dhe të rëndë, me buzë relativisht të mprehta.

Pas vlerësimit një nga një dhe të gjithave së bashku, të dëshmisë së të dëmtuarës A.G., ekspertit të IPFK Dr. A.G. dhe provave materiale të administruara në shqyrtim gjyqësor, trupi gjykues është bindur se tani i akuzuari I.G. ka kryer veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, sepse sipas të dëmtuarës, tani e ndjera dhe tani i akuzuari kanë pasur mosmarrëveshje të natyrave të ndryshme, ndërsa motiv kryesor ka qenë fakti se tani i akuzuari gjithnjë ka qenë xheloz ndaj tani të ndjerës, dhe i njëjti i ka kërcënuar se do t'i mbys edhe nënën edhe fëmijët e tyre, derisa nga IPFK është vërtetuar se tani i akuzuari nuk ka pasur çrregullim të kualitetit psikotik, akut dhe kronik, prapambetje mendore apo çrregullim mendor si pasojë e dëmtimeve cerebrovaskulare trunore, e po ashtu nuk janë gjetur elemente të natyrës psikiatrike dhe psikologjike që kanë mundur të ndikojnë në aftësinë për të kuptuar dhe kontrolluar veprimet e veta, ndërsa nga provat materiale është vërtetuar se tani e ndjera S.G. është goditur në kokë në anën e majtë me sëpatë, derisa ajo ishte duke fjetur në shtrat, dhe se shkaku i vdekjes së tani të ndjerës S.G., është si rrjedhojë e shkatërrimit të masës trunore, gjakderdhjes brenda trunore dhe nën cipat e buta të trurit në të dyja anët e saj, e shoqëruar me thyerje të kockave, si pasojë e plagëve të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë dhe të rëndë, me buzë relativisht të mprehta.

Po ashtu, se tani i akuzuari ka kryer veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është vërtetuar edhe nga fakti se pas kryerjes së veprës penale, vet tani i akuzuari ka shkuar në polici dhe i ka njoftuar se e ka vrarë bashkëshorten e tij, gjë për të cilën e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar të datës 30.05.2023 në çështjen penale PKR.nr.188/2023, e kthyer në ri gjykim nga gjykata e shkallës së dytë.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, është vërtetuar dashja e tani të akuzuarit për ta kryer veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, sepse para kësaj ngjarje tani i akuzuari i ka kërcënuar se do t'i mbys tani të ndjerën, djalin dhe vajzën, të cilët kanë menduar se thëniet e tij janë momentale, duke mos besuar se do të bënte diçka të tillë, ndërsa veprën penale e ka kryer duke shfrytëzuar kohën kur tani e ndjera ishte duke fjetur, me qëllim që të njëjtën ta zinte të pa përgatitur për një situatë të tillë, pastaj me sëpatë, si mjet i rrezikshëm për shkaktimin e lëndimeve trupore, e ka goditur disa herë në kokë në mënyrë posaçërisht mizore tani të ndjerën S.G., e nga të cilat goditje e njëjta nuk ka arritur të reagoj por ka mbetur në shtrat ashtu siç ka qenë duke fjetur dhe si pasojë e këtyre goditjeve të tani të akuzuarit ka ardhur deri te vdekja e saj, e pastaj në gjendje gjakftohtësie ka shkuar në polici dhe ka lajmëruar se e ka vrarë bashkëshorten e tij.

Sa i përket pretendimeve të mbrojtëses së të akuzuarit I.G., se nga raporti i Institutit të Psikiatrisë Forenzike të Kosovës – në vijim IPFK i datës 15.02.2023 nuk është arritur të vërtetohet saktë nëse i akuzuari në kohën për të cilën akuzohet se e ka kryer veprën penale ka qenë në gjendje ta kuptoj rëndësinë e veprimeve të tij pasi që edhe nga raporti raportohet për një gjendje të vazhdueshme të vetëbesimit të ulët, ndjenjën e inferioritetit e të qenit i neglizhuar, i pa dobishëm, jo i dashur, i pa respektuar, për faktin se i njëjti nuk është marrë parasysh nga familjarët, konkretisht nga ish bashkëshortja, e më vonë edhe nga fëmijët dhe se mendimet apo propozimet e tij nuk janë përfillur, janë neglizhuar dhe se në marrjen e vendimeve familjare ka qenë totalisht i pa përfshirë, duke ndikuar që i njëjti të ndihet si i tillë dhe krejt kjo ka ndodhur në vazhdimësi është e pamundur të mos ndikoj në gjendjen shëndetësore, marrë parasysh edhe moshën e tij, e krejt kjo duke u nisur edhe nga të drejtat dhe obligimet bashkëshortore që bashkëshortët kanë në martesë, që të jenë të barabartë në mënyrë reciproke, ta ndihmojnë, respektojnë dhe mbështesin njëri tjetrin në të gjitha vendimet familjare, duke shtuar se ky raport është përfshirë më shkelje të dispozitave ligjore në fuqi, nuk ka qenë objektiv dhe i njëjti është përfshirë në shkelje të afateve ligjore si për nga ekspertimi ashtu edhe për nga komunikimi dhe me gabime të shumta teknike dhe i mangët, janë pretendime të pa bazuara, të pa mbështetura dhe të pa argumentuara me dispozita konkrete ligjore, e po ashtu mbrojtësja i ka dhënë vetes të drejtë që të vlerësoj edhe mendimin e ekspertëve profesionistë në lëmin e psikiatrisë forenzike, duke mos qenë eksperte e kësaj lëmie.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të akuzuarit, trupi gjykues ka marrë në konsideratë rrethanat lehtësuese siç janë: shprehja e keqardhjes dhe pendimit nga i akuzuari në fjalën e tij përfundimtare, moshën e tij e shtyrë dhe sipas të dhënave të sistemit SMIL, të kësaj gjykate, nuk rezulton të jetë dënuar më parë për ndonjë vepër tjetër penale, ndërsa si rrethana rënduese për tani të akuzuarin I.G., gjykata ka marrë parasysh rrethanat si në vijim: shkallën e përgjegjësisë penale, përkatësisht i njëjti në kohën e kryerjes së veprës penale nuk ka pasur çrregullim të kualitetit psikotik akut dhe kronik, prapambetje mendore apo çrregullim mendor si pasojë e dëmtimeve cerebrovaskulare trunore, e po ashtu nuk janë gjetur elemente të natyrës psikiatrike dhe psikologjike që kanë mundur të ndikojnë në aftësinë për të kuptuar dhe kontrolluar veprimet e veta; motivet për kryerjen e veprës, përkatësisht motivi i xhelozisë ndaj tani të ndjerës për të cilën ka dyshuar se po e tradhtonte; intensiteti i rrezikimit apo dëmtimit të

vlerës së mbrojtur, përkatësisht tani i akuzuari me rastin e kryerjes së veprës penale ka shfaqur një intensitet të lartë duke e goditur disa herë në kokë me sëpatë dhe duke e privuar nga jeta tani të ndjerën S.G. derisa e njëjta ishte duke fjetur në shtratin e saj; rrethanat në të cilat është kryer vepra, përkatësisht i akuzuari ka vepruar në mënyrë dinake dhe mizore, kur me sëpatë e ka goditur tani të ndjerën në kokë derisa ajo ishte duke fjetur; shkallën e lartë të pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprën penale, përkatësisht tani i akuzuari e ka goditur disa herë me sëpatë në kokë tani të ndjerën; shkallën e lartë të dashjes nga ana e personi të dënuar, përkatësisht i akuzuari me dashje ka marrë mjetin e kryerjes së veprës penale – sëpatën dhe me të e ka goditur në kokë tani të ndjerën derisa ajo ishte duke fjetur; vepra penale është kryer në mënyrë posaçërisht mizore, përkatësisht i akuzuari me sëpatë disa herë e ka goditur në kokë tani të ndjerën derisa ajo po flinte në shtrat; viktimja e veprës penale ka qenë posaçërisht e pambrojtur apo e ndjeshme, përkatësisht tani e ndjera nuk ka qenë në gjendje të mbrohet apo lajmëroj të tjerët sepse tani i akuzuari e ka shfrytëzuar situatën, përkatësisht e ka goditur me sëpatë derisa tani e ndjera po flinte; mosha e viktimës, përkatësisht tani e ndjera ishte e moshës së shtyrë, afër 64 vjeçe; shkallën e dëmit të shkaktuar nga tani i akuzuari, pasi si pasojë e veprimeve të tij ka ardhur deri te vdekja e tani të ndjerës S.G.; dhe tani i akuzuari veprën penale të vrasje së rëndë e ka kryer ndaj anëtares së familjes së tij, përkatësisht bashkëshortes së tij.

Po ashtu, me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka marrë parasysh faktin se sipas të dëmtuarës - dëshmitares A.G., nëna e saj – tani e ndjera S.G. është kujdesur për babai e saj – tani të akuzuarin I.G., përkatësisht është kujdesur për ushqimin e tij, e ka trajtuar atë – tani të akuzuarin si fëmijë, pasi i njëjti nuk ka pasur patentë shofer dhe nuk ka punuar, ndërsa nëna e saj tani e ndjerë e ka sjellë rrogën në shtëpi, e në krahasim siç tani i akuzuari është sjellë me të, ajo – tani e ndjera e ka marrë gjithmonë me të mirë, duke shtuar se asnjëherë nuk ka vërejtur se nëna e saj po shkonte me dikë tjetër, por se tani të akuzuarit i kishte hyrë një mendje e keqe në kokë dhe e ka kryer vrasjen.

Andaj, gjykata të akuzuarit si më lart i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar atij, i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën është shpallur fajtorë, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me dënimin e shqiptuar ndaj tij, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK, përkatësisht të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandaloi persona të tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga veprat penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, për ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi që të akuzuarit I.G. t'i konfiskohet arma e ftohtë – sëpata, si send i përdorur për kryerjen e veprës penale, u mor në bazë të nenit 269 dhe 277 të KPP.

Për llogaritjen e masës së paraburgimit në dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit, është vendosur konform dispozitës së nenit 79, par. 1 të KPRK.

Pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, në bazë të nenit 462, par. 1 dhe 2 të KPP, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, është marrë në bazë të nenit 449, par. 1 të KPP, kurse vendimi mbi taksën për kompensimin e viktimave të krimit u mor në bazë të nenit 36, par. 3.2 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në këtë rast, gjykata është bazuar edhe në nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, për një proces të hapur dhe të rregullt, që çdo person i akuzuar ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, duke pasur parasysh edhe bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij, si dhe në parimin që çdo person i akuzuar për një veprë penale të prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

Vendimin që në dënimin e shqiptuar, të akuzuarit t'i llogaritet edhe koha e kaluar nën masën e paraburgimit prej datës prej datës 25.11.2022 e deri sa të jetë nën këtë masë, u mor konform nenit 79, par. 1 të KPRK.

Ndërsa, vendimi që të akuzuarit t'i konfiskohet sēpata - si mjet i pērshtatshēm për shkaktimin e lëndimeve të rēnda trupore dhe rrezikimin e jetēs sē personit, është marrē në bazē të nenit 270, par. 1 të KPP.

Nē bazē të nenit 462, par. 3 të KPP, pala e dēmtuar është udhēzuar nē kontest civil pēr realizimin e kērkēsēs pasurore-juridike, pasi që të dhēnat e mbledhura nē procedurē penale nuk paraqesin bazē të sigurt pēr gjykim të plotē, e as të pjesērishēm.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurēs penale dhe paushallit gjyqēsor, u mor nē bazē të nenit 452, par. 1 të KPP, ndērsa vendimi mbi taksēn pēr kompensimin e viktimave të kimit u mor nē bazē të neneve: 3; 6 dhe 39, par .3.2 të Ligjit nr. 05/L-036 pēr Kompensimin e Viktimave të Kimit.

Nga sa u tha mē lart dhe nē bazē të neneve 173 par. 1 pikat 1.3 dhe 1.4 të KPRK e 364 të KPP, u vendos si nē dispozitiv të kētij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është pērpiluar me datē 22.04.2024.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA  
PKR.nr.299/2023, datë 17.04.2024.

Bashkēpunētore profesionale  
Arbenita Hoxha Koleci

Kryetari i trupit gjykues  
Naser Foniqi

**UDHËZIMI PËR MJETET JURIDIKE:**

Kundēr kētij aktgjykimi, ankesē mund të paraqesin personat e autorizuar **brenda tridhjetē (30) ditësh**, nga dita e dorēzimit të kopjes sē aktgjykimit. Ankesa bëhet pērmes kēsaj Gjykate, pēr Gjykatēn e Apelit nē Prishtinē.